



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

Nr. **3736** Prot.

Tiranë, më **27**/02/2026

UDHËZIM

Nr. **7** Datë **27**/02/2026

“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2027-2029”

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ministri i Financave:

UDHËZON :

I. Afatet dhe fazat e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029

a) Faza e parë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm

1. Faza e parë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm njihet si faza strategjike. Vendimet më të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor, do të merren gjatë fazës strategjike dhe do të përkthehen në tavane të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve të cilat duhet të respektohen gjatë fazës teknike. Të gjitha vendimet prioritare për financimin e politikave të reja merren gjatë fazës strategjike, duke përfshirë edhe vendimet për investime të reja publike.
2. Faza e parë e PBA-së (Faza Strategjike) përcakton, për shqyrtim dhe miratim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore:
 - a) Propozime për Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) dhe Planin e Shpenzimeve të Programit (PSHP) të ‘Politikave Ekzistuese’, të programit të përgatitura brenda tavaneve të fazës së parë.
 - b) Propozime për DPP dhe PSHP të “Politikave të Reja” të programit.
3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet jo më vonë se data 31 janar, për shqyrtim dhe miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave përmban të dhënat për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore.

4. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars 2026.
5. Në këtë raport përfshihet:
 - a) metodologjia e përdorur për parashikimin e të ardhurave;
 - b) analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimit të atyre ekzistuese; dhe
 - c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.
6. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
7. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 për çdo program, miratohen nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 15 mars.
8. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA 2027-2029 për çdo program, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton Udhëzimin e Brendshëm të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP).
9. Udhëzimi i Brendshëm i Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore përmban:
 - a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve;
 - b. Tavanet Përgatitore të PBA 2027-2029 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore.
 - c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe Grupin për Menaxhim Strategjik (GMS) për të përgatitur DPP dhe PSHP.
 - d. Manualin e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV);
10. Për qëllime të menaxhimit të brendshëm, procedurat e sugjeruara dhe afatet e brendshme për miratimin e informacionin të Dokumentit të PBA-së të Fazës së parë (Projekt Dokumentin e PBA-së) paraqiten në Shtojcën 6.
11. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP), paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatorit të GMS, brenda muajit prill 2026. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica romë dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.
12. Pas miratimit të të gjitha formateve të PBA-së në Fazën e parë, informacioni i dokumentit të PBA-së së Fazës së parë miratohet nga kordinatori i GMS dhe më pas paraqitet në GMS për miratimin e tij deri më 30 Maj 2026.
13. Kërkesat buxhetore të dorëzuara te kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.
14. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 1 Qershor 2026 duhet të dërgojë me shkrim dhe në rrugë elektronike, në Ministrinë e Financave Projekt-Dokumentin e PBA 2027-2029, të përgatitur sipas formateve pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
15. Ministria e Financave, analizon dhe përgatit një raport me rekomandime mbi Projekt-Dokumentin e PBA 2027-2029 për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe ja dërgon zyrtarisht këtyre të fundit brenda datës 20 qershor 2026.

16. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.
17. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet pranë këshillit të NJVQV-së, Projekt-Dokumentin e PBA 2027-2029, të miratuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik, së bashku me raportin me rekomandime të Ministrisë së Financave.
18. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton Projekt-Dokumentin e PBA 2027-2029, dhe shpreh opinionin e tij mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave brenda datës 30 qershor 2026.
19. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2026, publikon dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029.
20. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2027-2029 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor të miratuar gjatë vitit 2026.
21. Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë do të përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetin 2027 bazuar në metodologjinë e re sipas Shtojcës 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) Faza e dytë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm

22. Faza e dytë e përgatitjes së Dokumentit të Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm përcaktohet si faza teknike e përgatitjes së buxhetit (vjetor).
23. Faza e dytë e PBA-së konsiston në rishikimin e propozimeve për DPP dhe PSHP brenda tavanëve të fazës së dytë për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e NJVQV-ë *(përfshirë çdo rregullim të DPP dhe PSHP nga momenti i miratimit të Këshillit të kërkesave për “politika të reja”)*.
24. Pjesë e fazës së dytë është edhe përgatitja e Buxhetit Vjetor që përbëhet nga:
 - a) Rishikime të mëtejshme të propozimeve për DPP dhe PSHP brenda tavanëve të fazës së dytë për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e NJVQV-së.
 - b) Reflektimet përfundimtare të ndryshimeve në parashikimin e të ardhurave, DPP dhe PSHP në përputhje me vendimin e këshillit të NJVQV-së për PBA-në dhe buxhetin vjetor.
25. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe trasfertave nga buxheti i shtetit, Ministri i Financave brenda datës 10 korrik dërgon udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore.
26. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim brenda datës 15 korrik 2026 tavanet përfundimtare në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik 2026.
27. Për qëllime të menaxhimit të brendshëm, detyrat e sugjeruara dhe afatet e brendshme për miratimin e informacionit të dokumentit të PBA-së në Fazën e dytë (Dokumenti i Rishikuar i PBA-së) paraqiten në Shtojcën 7.
28. Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve nga Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nxjerr

udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese. Ky udhëzim përmban:

- a) Tavanet përfundimtare të shpenzimeve sipas programeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore për çdo vit të PBA-së;
 - b) Afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.
29. Pas marrjes së Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore fillon menjëherë punën për përgatitjen e Dokumentit të Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm. Në këtë dokument reflektohet shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve të cilat kanë pësuar ndryshime në tavane.
30. EMP-të rishikojnë DPP dhe PSHP brenda tavanit të Fazës së dytë. Në këto ndryshime përfshihet çdo udhëzim nga Këshilli pas rishikimit të PBA-së së Fazës së parë (Projekt Dokumentit të PBA), si edhe:
- a) Çdo rishikim të shpenzimeve të “Politikave ekzistuese”;
 - b) Përfshirjen e çdo politike të re të miratuar në tërësi ose pjesërisht nga Këshilli.
31. Pas miratimit të të gjitha formateve të PBA-së në Fazën e dytë, Dokumenti i PBA-së së Fazës së dytë (Dokumenti i Rishikuar i PBA-së) miratohet nga Koordinatori i GMS dhe më pas paraqitet në GMS për miratimin përfundimtar deri më 30 gusht 2026.
32. Pas finalizimit të Dokumentit të Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator 2026. Proçesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, bëhen pjesë e Dokumentit të Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm.
33. Koordinatori i GMS i mbështetur nga sekretari i GMS, mendimet e marra nga procesi i konsultimeve i shpërndan tek të gjithë anëtarët e GMS dhe drejtuesit e programeve. Këto sugjerime bëhen pjesë e diskutimeve në GMS në një mbledhje të posaçme në përfundim të së cilës dilet me konkluzione konkrete në lidhje me sugjerimet përkatëse.
34. Këshilli miraton dokumentin e PBA-së të Fazës së dytë (Dokumenti i Rishikuar i PBA-së) deri më 15 shtator 2026.
35. Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave Dokumentin e Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.
36. Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave brenda datës 20 tetor, dërgon mendimet përfundimtare për t’u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.

c) Faza Përfundimtare e PBA-së

37. Pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit, Ministria e Financave hedh informacionin përfundimtar në SMBV lidhur me transfertat e buxhetit qendror që do të përfitojë çdo NJVQV.
38. Në hapin e parë të kësaj faze të PBA-së, GMS rishikon informacionin e paraqitur në tre formatet e mëposhtme:

- a) Formati i parashikimit afatmesëm të të ardhurave.
 - b) Formati i tavanëve përfundimtarë të PBA-së.
 - c) Formati i tavanëve në nivel programi.
39. Koordinator i GMS jep udhëzime për EMP-të për të rishikuar DPP dhe PSHP brenda Tavanit Përfundimtar të Programit.
40. EMP-të hartojnë DPP dhe PSHP brenda tavanit të Fazës Përfundimtare të PBA-së.
41. Drejtori i Financës/Buxhetit reflekton çdo rishikim që kërkohet për informacionin e përgjithshëm të NJVQV-së.
42. Drejtuesit e EMP-së bëjnë çdo rishikim që kërkohet për të dhënat bazë të programit.
43. Pas miratimit të të gjitha formateve të PBA-së në Fazën Përfundimtare, Dokumenti i PBA- (Dokumenti Përfundimtar i PBA-së) aprovohet nga Koordinator i GMS-së dhe më pas paraqitet në GMS për miratimin e tij.
44. Pas marrjes së mendimeve përfundimtare (sipas rastit) nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, së bashku me projektbuxhetin vjetor jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor.
45. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në një aneks të veçantë të projektit të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar, paraqet mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimin e tij për marrjen në konsideratë të tyre.
46. Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më vonë se data 25 dhjetor.

d) PBA përfundimtare dhe Buxheti Vjetor

47. Buxheti Vjetor përfshin:
- a) Parashikimin e të ardhurave nga Viti 1 i PBA-së së Fazës Përfundimtare të PBA-së.
 - b) DPP dhe PSHP nga Viti 1 i PBA-së së Fazës Përfundimtare.
 - c) Informacionin e përgjithshëm për NJVQV-në.
 - d) Informacionin bazë të programit.
 - e) Detajet e tjera të Buxhetit Vjetor (formatet FB1, FB2, FB3, FB4, FB5, FB6).
48. Parashikimi i të ardhurave, DPP dhe PSHP, informacioni i përgjithshëm i NJVQV-së dhe informacioni bazë për programin për buxhetin vjetor miratohen automatikisht si pjesë e miratimit teknik të PBA-së së Fazës Përfundimtare.
49. Pas miratimit të plotë teknik të formateve FB1, FB2, FB3, FB4 dhe FB5, FB6 raportet e mëposhtme paraqiten në Këshill, si Buxheti Vjetor për shqyrtim dhe miratim deri më 30 Nëntor 2026:
- a) Dokumentacioni bazë i buxhetit vjetor:**
 - i. BV1 - Buxheti i NJVQV-së sipas programit dhe njësive të shpenzuese
 - ii. BV2 - Tavanet e të PBA-së sipas programeve
 - iii. BV3 - Parashikimi i të ardhurave
 - iv. BV4 - Shpenzimet e NJVQV-së sipas klasifikimit ekonomik
 - v. BV5 - Numri i punonjësve të NJVQV-së
 - b) Dokumentacioni shtesë i buxhetit vjetor:**

- i. BV6 - Shpenzimet e NJVQV-së sipas të gjitha klasifikimeve buxhetore
 - ii. BV7 - Lista e projekteve të investimeve të NJVQV-së
 - iii. BV8 - Efekti financiar i përjashtimeve apo lehtësimeve fiskale
 - iv. BV9 - Lista e njësive shpenzuese të NJVQV-së
 - v. BV10 - Deklarata e politikës së programit
 - vi. BV11 – Detyrimet e Prapambetura
 - vii. BV12 – Plani i menaxhimit të risqeve
 - viii. BV13 - Lista e Projekteve Koncesionare/PPP
 - ix. BV14 – Shoqëritë aksionere publike
 - x. BV15 – Plani i arkës
50. Dokumenti i PBA-së në Fazën Përfundimtare (Dokumenti Përfundimtar i PBA-së) gjithashtu paraqitet në Këshill së bashku me Dokumentin e Buxhetit Vjetor.
51. Këshilli miraton dokumentin e PBA-së së Fazës Përfundimtare (Dokumenti Përfundimtar i PBA-së) dhe udhëzon GMS-në për të pasqyruar çdo ndryshim në dokument në përputhje me vendimin e tij për Buxhetin Vjetor dhe PBA deri më 25 Dhjetor 2026.

e) Finalizimi i dokumentit të PBA-së (Dokumenti përfundimtar i PBA-së dhe Dokumenti i Buxhetit Vjetor)

52. Vendimi i Këshillit të NJVQV për Buxhetin Vjetor përcakton çdo ndryshim përfundimtar në shpërndarjen e burimeve që do të përfshihen në Vitin 1 të Dokumentit Përfundimtar të PBA-së.
53. Këshilli i NJVQV mund të udhëzojë gjithashtu Kryetarin e NJVQV-së të bëjë ndryshime përfundimtare në shpërndarjen e shpenzimeve për vitet 2 dhe 3 të Dokumentit Përfundimtar të PBA-së.
54. Në çdo rast, Kryetari i NJVQV-së, përmes Kordinatorit të GMS-së, udhëzon drejtuesit e EMP-ve të bëjnë çdo ndryshim që kërkohet në:
- a) Planet e shpenzimeve të vitit 1 të PBA-së, për të ruajtur konsistencën mes Vitit 1 të PBA-së dhe vendimit të Këshillit për Buxhetin Vjetor.
 - b) Planet e shpenzimeve të vitit 2 dhe vitit 3 të PBA-së, siç është udhëzuar nga Këshilli dhe/ose për të ruajtur konsistencën mes planeve të shpenzimeve të Vitit 1 dhe planeve të shpenzimeve të Vitit 2, Vitit 3.
 - c) DPP për Vitin 1, Vitin 2 dhe Vitin 3 në përputhje me çdo rishikim të planeve përkatëse të shpenzimeve.
55. Dokumenti Përfundimtar i PBA-së, i cili përfshin Buxhetin Vjetor, publikohet në faqen e internetit të NJVQV-së deri më 31 Dhjetor 2026.

II. Konsultimet Publike.

56. Këshilli i NJVQV-së zhvillon konsultime me publikun përgjatë fazave të procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

III. Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV)

57. Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 dhe buxhetit vjetor do të përgatitet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).
58. SMBV është zhvilluar për të funksionuar me të dyja Metodologjitë, 2018 dhe 2022. Për përgatitjen e PBA-së dhe Buxhetit Vjetor në vitin 2026, 18 bashki dhe 3 qarqe do të përdorin versionin e “Metodologjisë 2022” të SMBV. Të gjitha NJVQV-të e tjera do të përdorin versionin e “Metodologjisë 2018” të SMBV-së në vitin 2026.
59. Pranë Ministrisë së Financave në drejtorinë përgjegjëse për financat vendore do të ofrohet shërbimi i asistencës në ndihmë të të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në plotësimin dhe përdorimin e këtij sistemi.
60. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor njësitë e vetëqeverisjes vendore do të organizojnë planifikimin e shpenzimeve buxhetore në përputhje me 20 programet e përcaktuara, sipas Shtojcës nr.1 të udhëzimit standard nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.
61. Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë do të plotësojnë SMBV sipas metodologjisë së re të përcaktuar në Shtojcën 5 të këtij udhëzimi.
62. Për çdo NJVQV do të vihet në dispozicion një llogari përdoruesi me fjalëkalimin përkatës, që do të përkohë me rolin e Sekretarit të GMS (nëpunësit zbatues) të NJVQV, i cili do të ketë mundësinë të krijojë llogaritë për përdorimin e SMBV për anëtarët e tjerë të stafit të NJVQV bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e PBA dhe Buxhetit Vjetor.

IV. Proceset dhe formatet për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029

4.1 Proceset për përgatitjen e PBA Vendor 2027-2029

63. **Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2027-2029**, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 9 datë 15.01.2026, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
64. **Tavanet e Përgatitjes së PBA Vendor 2027-2029.** Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të programit të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të NJVQV-së, është vendosja e taveve të shpenzimeve. Një “tavan” në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar.
Me alokimin e Taveve të Përgatitjes së PBA-së Vendore 2027-2029 për programet buxhetore, Këshilli i NJVQV-së garanton që shpenzimet të planifikohen në mënyrë që të buxhetojnë politikat, prioritetet, objektivat strategjike të NJVQV-së dhe të jenë në përputhje me alokimin strategjik të burimeve.
65. **Organizimi Institucional.** Manaxhimi i brendshëm i Proçesit të përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV-së bazohet në mbledhjet e Grupit për Menaxhim Strategjik dhe mbledhjet e

secilit prej Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP). Secila nga këto mbledhje është e lidhur me një fazë të rëndësishme të përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV.

Mbledhjet e GMS dhe mbledhjet e EMP janë të nevojshme për një proces të suksesshëm të përgatitjes së PBA-së.

66. **Përgatitja e dokumentit të PBA-së.** Bazuar në informacionet e marra nga secili prej DEMP në formën e Deklaratës së Politikës së Programit, si edhe kërkesave të shpenzimeve sipas formateve përkatëse, Koordinatori i GMS me ndihmën e Sekretarit të GMS bën përmbledhjen dhe harmozimin e tyre në Projekt-dokumentin e PBA Vendor 2027-2029. Ky dokument i paraqitet për miratim GMS dhe pastaj dërgohet në Ministrinë e Financave brenda datës 1 Qershor 2026.

4.2 Formatet e Programit Buxhetor Afatmesëm, të hartuara në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor

67. Procesi i miratimit të PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027, në çdo fazë do të realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

68. Miratimi teknik i PBA-së përfundimtare varet nga miratimi i të gjitha formateve të SMBV-së që përbëjnë PBA-në.

69. Në formatet e mëposhtme të SMBV-së sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për dokumentin përfundimtar të PBA-së:

- a) Parashikimi i të ardhurave afatmesme paraqitet në formatin “Parashikimi i të ardhurave”, me të dhëna për katër vitet e kaluara buxhetore, vitin aktual buxhetor (Plani Fillestar dhe Plani i Rishikuar) dhe tre vitet e ardhshme.
- b) Parashikimi i tavanëve të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm paraqitet në formatin “PSHP2: Tavanet përgatitore të PBA”, me të dhëna për buxhetin e rishikuar të vitit aktual dhe tre vitet e ardhshme.
- c) “Politikat ekzistuese” në deklaratën e politikës së programit (DPP) dhe planin e shpenzimeve të programit (PSHP) miratohen përmes formateve të SMBV si në vijim: Specifikimi i Programeve (DPP1, DPP2, DPP3), Plani i Shpenzimeve (PSHP1, PSHP2, PSHP3, PSHP4, PSHP5, PSHP6). Përmbajtja e këtyre formateve përshkruhet në Manualin e Përdorimit të SMBV.
- d) Informacioni i Përgjithshëm për NJVQV-në sigurohet në formatet: NJVQV1, NJVQV2, NJVQV3, NJVQV4, NJVQV5, NJVQV6. Përmbajtja e këtyre formateve përshkruhet në Manualin e Përdorimit të SMBV.
- e) Të dhënat bazë të programit sigurohen në formatin DPP4 me emërtimin: “Informacioni bazë i programit”.

70. Miratimi i një formati në SMBV ndodh kur zyrtari përkatës hyn në sistem me llogarinë e tij dhe klikon në butonin përkatës të miratimit, pasi të përfundojë një version i plotësuar i formatit.

71. Rendi i miratimit të formateve të PBA-së në SMBV është si vijon:

- a) “Formati i parashikimit të të ardhurave” miratohet në SMBV nga zyrtari përgjegjës për parashikimin e të ardhurave.
- b) “Formati i tavanëve të programit buxhetor afatmesëm” miratohet në SMBV nga Koordinatorin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) të NJVQV-së.

- c) Formatet e lidhura me 'Politikat ekzistuese' dhe 'Politikat e reja' të programeve miratohen në SMBV nga drejtuesi i EMP-së.
 - d) Formatet e informacionit të përgjithshëm të NJVQV-së miratohen në SMBV nga Koordinatori i GMS.
 - e) Formatet e të dhënave bazë të programit miratohet në SMBV nga drejtuesi i EMP-së.
72. Pas miratimit të të gjithë formateve të PBA-së siç përshkruhet në këtë udhëzim, të gjitha informacionet e PBA-së miratohen së pari nga Koordinatori GMS-së dhe më pas nga Kryetari i NJVQV-së, dhe raportet e mëposhtme bëhen pjesë e dokumentit të PBA 2027-2029:
- a) Raporti PBA1: Tavanet Përfundimtare të PBA
 - b) Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
 - c) Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
 - d) Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)
 - e) Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - f) Raporti PBA6: Deklarata e Politikës së Programit
 - g) Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit
 - h) Raporti PBA8: Projektet e Investimeve
 - i) Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin

4.3 Miratimi i formateve të Buxhetit Vjetor të hartuar në SMBV

73. Procesi i miratimit teknik në çdo fazë të përgatitjes së Buxhetit Vjetor do të kryhet përmes SMBV.
74. Parashikimi i të ardhurave në buxhetin vjetor miratohet automatikisht me miratimin në SMBV të formatit të parashikimit të të ardhurave si hapi i parë i Fazës Përfundimtare të PBA-së.
75. DPP dhe PSHP, informacioni i përgjithshëm për NJVQV-të dhe të dhënat bazë të programit në Buxhetin Vjetor miratohen automatikisht me miratimin në SMBV të formateve DPP1, DPP2, DPP3, DPP4, PSHP1, PSHP2, PSHP3, PSHP4, PSHP5, PSHP6, NJVQV1, NJVQV2, NJVQV3, NJVQV4, NJVQV5, NJVQV6, në fund të Fazës përfundimtare të PBA-së.
76. Projekt Buxheti Vjetor përmban gjithashtu detaje të tjera sipas formateve të mëposhtme:
- a) Formatet FB1 – Detajimi i shpenzimeve sipas llogarive ekonomike, burimeve të financimit dhe njësive shpenzuese për Vitin 1 të PBA-së.
 - b) Formatet FB2 – Detajimi i planit mujor të arkës sipas llogarive të grupuara ekonomike dhe njësive shpenzuese për Vitin 1 të PBA-së.
 - c) Formatet FB3 – Përrjashtimet fiskale (të ardhurat e munguara si pasojë e lehtësive fiskale ndaj bizneseve lokale).
 - d) Formatet FB4 – Plani i menaxhimit të riskut të Buxhetin Vjetor.
 - e) Formatet FB5 – Treguesit kryesorë financiarë të ndërmarrjeve publike, përfshirë subvencionet nga NJVQV-të.
 - f) Formatet FB6 – Planifikimi 4-mujor i produkteve sipas programeve buxhetore.

77. Formatet e tjera të Buxhetit Vjetor miratohen si më poshtë:
- a) Formati FB1 miratohet në SMBV nga Drejtori i Financës/Buxhetit.
 - b) Formati FB2 miratohet në SMBV nga Drejtori i Financës/Buxhetit.
 - c) Formati FB3 miratohet në SMBV nga Drejtori i Të Ardhurave Vendore.
 - d) Formati FB4 miratohet në SMBV nga Koordinatori i Riskut.
 - e) Formati FB5 miratohet në SMBV nga Drejtori i Financës/Buxhetit.
 - f) Formati FB6 miratohet në SMBV nga DEMP.
78. Pas miratimit të të gjithë formateve të Buxhetit Vjetor në SMBV, këto formate miratohen nga Koordinatori i GMS dhe më pas nga Kryetari i NJVQV-së.

V. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore

79. Niveli i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2027-2029, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2026. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.
80. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2027-2029, paraqitet në Shtojcën 1 “Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2027-2029 , bashkëlidhur udhëzimit.
81. Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, për periudhën 2027-2029, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar (Shtojca nr.3).
82. Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2027-2029 do të kenë një rritje përkatësisht, 2 % për vitet 2027-2028 dhe 1% për vitin 2029.

VI. Mënyrat e llogaritjes së transfertës të pakushtëzuar dhe të kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore

6.1 Transferta e pakushtëzuar

a) Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

83. Madhësia e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe transfertës sektoriale për rritjen e pagave për periudhën 2027-2029, paraqitet sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur udhëzimit.
84. Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2027-2029 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në përllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2027-2029 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km², numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

85. Madhësia e koeficientëve dhe të dhënat e nevojshme për llogaritjen e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme për vitet 2027-2029 do të jenë në përputhje me përcaktimet e Ankesit 1, të ligjit vjetor të buxhetit 2026.

b) Transferta e pakushtëzuar sektoriale

86. Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.
87. Bashkitë në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 duhet të parashikojnë fonde për ofrimin e infrastrukturës së përshtatshme për ushtrimin e funksionit të arsimit parashkollor.

c) Transferta e kushtëzuar

88. Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 në ministritë përkatëse të linjës për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara të pushteti vendor. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

VII. Dokumente që duhen marrë në shqyrtim gjatë përgatitjes së PBA 2027-2029

- a) Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.23 datë 30.07.2018 ‘Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore’, i ndryshuar.
- b) Udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave;
- c) Udhëzimi i Brendshëm i NJVQV-së për përgatitjen e PBA 2027-2029;
- d) Shtojca 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi “Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm për bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë;
- e) Plan i Strategjik i Zhvillimit/Plani i Përgjithshëm Vendor (i teritorrit, plani social, plani i zhvillimit ekonomik, plani për mbrojtjen e mjedisit), të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore;
- f) Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal;

VIII. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore

89. Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al.
90. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund ti drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e formateve të PBA-së sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
91. Nëpunësi i parë autorizues, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për buxhetin vendor analizon kërkesat buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe zhvillon takime konsultative me këto njësi sipas një kalendari të paracaktuar. Takimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në fokus kërkesat buxhetore të lidhura me financimin e buxhetit qendror për vetëqeverisjen vendore.

IX. Të tjera

92. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi janë shtojcat, bashkëlidhur si më poshtë:
- a) Shtojca 1 *“Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe transfertës sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2027-2029”*;
 - b) Shtojca 2 *“Struktura e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”*;
 - c) Shtojca 3 *“Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë për periudhën 2027-2029”*;
 - d) Shtojca 4 *“Produktet standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve”*;
 - e) Shtojca 5 *“Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit 2027 për Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë”*;
 - f) Shtojca 6 – *“Detyrat e sugjeruara dhe afatet e brendshme për miratimin e Dokumentit të PBA-së Faza e parë (Projekt Dokumenti i PBA-së)”*;
 - g) Shtojca 7 – *“Detyrat e sugjeruara dhe afatet e brendshme për miratimin e Dokumentit të PBA-së Faza e dytë (Dokumenti i Rishikuar i PBA-së)”*;
93. Paketa e plotë e udhëzimit dhe shtojcave bashkëlidhur mund të shkarkohen në linkun: <https://ëëë.financa.gov.al/buxheti-i-pushtetit-vendor/>.

MINISTËR

